

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Një ambasador i ri amerikan për një partneritet në ndryshim?
ADRESA	https://tpz.al/nje-ambasador-i-ri-amerikan-per-nje-partneritet-ne-ndryshim-i334162
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 16:07:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 16:03:14 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a021b5b67117d4c040ed1fc1ce17ace1c29733d4e70248c2f44361688cbe0506
TEKSTI	fc1b66d31bc5f4958cd9b70fcafdcb53f841bd9b491243666adf7598ef55adae
PAMJA	6436db01ebd2c6bdae966d146de3205620775712574009c0dcef3d7ae7aeebed

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5af9e5dafdd7ffe5c63853147c145d5277879c9714c8688c170c1f9db8afb735
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4faa6bac1fdb621d5bb536e84f6e17d5297f7948d21ccae873a60f4b83f7089c
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5af9e5dafdd7ffe5c63853147c145d5277879c9714c8688c170c1f9db8afb735>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET, 29 SEPTEMBER 2026, 18:03

Një ambasador i ri amerikan për një partneritet në ndryshim?

tpz.al TPZ



Eric Wendt dorëzon kredencialet në Tiranë, ndërsa Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara hyjnë në një fazë të re të partneritetit të tyre strategjik.

Eric P. Wendt, gjeneral-lejtnant në pension i Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara dhe ish-komandant i Shtabit të Operacioneve Speciale të NATO-s, ka marrë zyrtarisht detyrën si ambasadori i ri amerikan në Shqipëri, pasi i dorëzoi letrat kredenciale Presidentit Bajram Begaj.

Wendt i paraqiti kredencialet Presidentit Begaj të shtunën, më 26 shtator, në Presidencë, duke nisur zyrtarisht misionin e tij diplomatik në Tiranë. Në ceremoni ai shoqërohej nga bashkëshortja e tij, Katherine Wendt.

Presidenti Begaj i uroi ambasadorit të ri sukses në detyrë dhe rikonfirmoi angazhimin e Shqipërisë për forcimin e mëtejshëm të partneritetit strategjik me Shtetet e Bashkuara.

"Shtetet e Bashkuara mbeten një partner i pazëvendësueshëm për Shqipërinë, si për sigurinë, ashtu edhe për prosperitetin tonë," deklaroi Begaj pas takimit.

Ambasada Amerikane në Tiranë bëri të ditur se Wendt dhe Begaj rikonfirmuan marrëdhëniet e forta mes dy vendeve dhe diskutuan mbi një sërë përparësish të përbashkëta, përfshirë bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, rritjen ekonomike dhe luftën kundër grupeve kriminale transnacionale.

Ardhja e Wendt rikthen përfaqësimin amerikan në nivel ambasadori në Tiranë pas një periudhe të gjatë gjatë së cilës ambasada është drejtuar nga të ngarkuar me punë dhe përfaqësues të përkohshëm, pas përfundimit të mandatit të ish-ambasadores Yuri Kim në vitin 2023.

ide!

Ish-shefja e SHISH, nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiqet e saj

Nga Lorenc Vangjeli

Rikthimi i SHISH-it në politikë si banalitë

Nga Mero Baze

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xamatreгон pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

Shiko të tiera video

Emërimi i ambasadorit të ri vjen në një moment të veçantë për marrëdhëniet shqiptaro-amerikane. SHBA- të kanë luajtur një rol të rëndësishëm në disa prej kthesave më vendimtare të historisë moderne të Shqipërisë.

Albert Rakipi, ish-zëvendësministër i Punëve të Jashtme dhe kryetar i Institutit Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, e sheh rolin historik të Shteteve të Bashkuara si shumë më të gjerë sesa marrëdhëniet diplomatike tradicionale mes dy vendeve.

“Pak vende i detyrohen Shteteve të Bashkuara aq sa Shqipëria në momentet vendimtare të historisë së tyre moderne. Presidenti Woodrow Wilson kundërshtoi copëtimin e Shqipërisë në një kohë kur fuqitë evropiane ishin të gatshme ta ndanin atë; Shtetet e Bashkuara mbështetën fuqishëm transformimin demokratik postkomunist të Shqipërisë dhe anëtarësimin e saj në NATO; ndërsa udhëheqja amerikane ishte vendimtare në ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë dhe në rrugën drejt pavarësisë së Kosovës. Në Tiranë, në vitin 2007, Presidenti George W. Bush e bëri të qartë pa asnjë ekuivok qëndrimin amerikan: rezultati përfundimtar për Kosovën do të ishte pavarësia.”

Marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara janë lidhur vazhdimisht me çështje themelore të shtetit shqiptar, sigurisë dhe orientimit të tij perëndimor. Kundërshtimi i Presidentit Wilson ndaj planeve që rrezikonin integritetin territorial të Shqipërisë pas Luftës së Parë Botërore mbetet një nga momentet më të rëndësishme në kujtesën historike shqiptare për Shtetet e Bashkuara.

Pas rënies së komunizmit, Uashingtoni mbështeti fuqishëm transformimin demokratik të Shqipërisë dhe integrimin e saj në strukturat euroatlantike. Anëtarësimi në NATO në vitin 2009 shënoi një nga arritjet më të rëndësishme të politikës së jashtme shqiptare pas vitit 1990 dhe e ankoroj përfundimisht vendin në arkitekturën perëndimore të sigurisë.

Kriza e Kosovës e forcoi edhe më tej këtë lidhje strategjike. Shtetet e Bashkuara luajtën një rol udhëheqës në ndërhyrjen e NATO-s në vitin 1999 dhe mbështetën më pas pavarësinë e Kosovës. Gjatë vizitës së tij në Tiranë në qershor 2007, Presidenti George W. Bush deklaroi publikisht se procesi për Kosovën duhej të përfundonte me pavarësinë e saj.

Ambasadori i ri mbërrin në Shqipëri me një përvojë të gjerë ushtarake, diplomatike dhe në fushën e sigurisë.

Ish-“Green Beret”, Wendt shërbeu për më shumë se 34 vjet në Ushtrinë amerikane dhe mbajti një sërë postesh të larta komanduese. Detyra e tij e fundit në uniformë ishte ajo e komandantit të Shtabit të Operacioneve Speciale të NATO-s, ku kishte përgjegjësi për forcat speciale të Aleancës, përfshirë bashkëpunimin me njësitë shqiptare.

Gjatë karrierës së tij ai ka shërbyer gjithashtu si shef shtabi i Komandës Amerikane të Paqësorit dhe si komandant i Qendrës dhe Shkollës së Luftës Speciale “John F. Kennedy” të Ushtrisë së SHBA-së.

Wendt ka punuar gjithashtu për dy vjet me Departamentin Amerikan të Shtetit në Ambasadën e SHBA-së në Jerusalem, ku drejtoi një koalicion prej tetë vendesh si Koordinator Amerikan i Sigurisë për Izraelin dhe Autoritetin Palestinez, duke raportuar drejtpërdrejt te Sekretari i Shtetit.

Lidhjet e tij me Shqipërinë nuk nisin me emërimin si ambasador. Gjatë shërbimit në NATO, Wendt ka punuar me drejtues të mbrojtjes dhe ushtarakë shqiptarë dhe ka pasur përgjegjësi që përfshinin edhe kontingjente shqiptare në misione ndërkombëtare.

Presidenti Donald Trump e nominoi Wendt në prill si ambasador të jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë në Shqipëri. Senati amerikan e konfirmoi emërimin në gusht dhe më pas Wendt bëri betimin përpara se të udhëtonte drejt Tiranës.

Gjatë procesit të konfirmimit në Senat, ai renditi ndër përparësitë e tij forcimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar transnacional, sigurinë kibernetike dhe zgjerimin e marrëdhënieve ekonomike e tregtare. Ai e cilësoi Shqipërinë një partnere të fortë të Shteteve të Bashkuara dhe një aleate të rëndësishme

në NATO, duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit dypalësh për sigurinë dhe stabilitetin rajonal.

Por ardhja e ambasadorit të ri përkon gjithashtu me një moment kur marrëdhëniet shqiptaro-amerikane përballen me pyetjen se si mund të evoluojnë përtej themeleve të tyre historike dhe si mund t'i përshtaten një realiteti të ri gjeopolitik.

Albert Rakipi thotë se faza e ardhshme e këtij partneriteti do të kërkojë më shumë sesa mbështetja te trashëgimia e së kaluarës.

"Marrëdhëniet shqiptaro-amerikane po hyjnë tani në një periudhë tranzicioni. Themelet historike të partneritetit mbeten jashtëzakonisht të forta, por vetëm historia nuk mjafton për të mbajtur gjallë një marrëdhënie strategjike. Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara kanë nevojë për ide të reja dhe për një partneritet më të pjekur, të bazuar jo në varësi, por në interesa strategjike të përbashkëta, institucione demokratike më të forta, bashkëpunim ekonomik dhe në aftësinë e Shqipërisë për të luajtur një rol domethënës në sigurinë dhe stabilitetin e Ballkanit Perëndimor."

Marrëdhëniet ekonomike mbeten një nga fushat më pak të zhvilluara të partneritetit, sidomos në krahasim me thellësinë e lidhjeve politike, diplomatike dhe ushtarake. Roli i Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor, forcimi i institucioneve demokratike dhe zgjerimi i bashkëpunimit ekonomik pritet të jenë ndër elementet kryesore që do të përcaktojnë përmbajtjen e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane në vitet e ardhshme.

Wendt ka përfunduar studimet bachelor në Universitetin e Kalifornisë, Santa Barbara, dhe studimet master në Naval Postgraduate School në Monterey të Kalifornisë. Pas largimit nga shërbimi aktiv, ai ka dhënë mësim për komandim dhe lidërsip në Naval Postgraduate School.

Ai flet arabisht dhe koreanisht dhe është nderuar me një sërë dekoratash të larta ushtarake dhe civile, përfshirë Defense Distinguished Service Medal, Distinguished Service Medal, Bronze Star Medal dhe Superior Honor Award të Departamentit Amerikan të Shtetit.

Wendt nis kështu misionin e tij në Tiranë me një përvojë të gjatë në NATO, në operacionet shumëkombëshe të sigurisë dhe në diplomaci, në një kohë kur Tirana dhe Uashingtoni duhet të përcaktojnë jo vetëm vazhdimësinë, por edhe përmbajtjen e re të një prej partneriteteve më të rëndësishme ndërkombëtare të Shqipërisë./Tirana Times

AKTUALITET / 29 September 2026, 17:32

Ambasadori Wendt merr detyrën/ Ambasada e SHBA: Një kapitull i ri nis në Shqipëri, aleancat tona më të forta kur qëndrojmë së bashku

AKTUALITET / 29 September 2026, 17:26

Aksidenti 14-vjeçaren me motomjet dhe u largua nga vendi i ngjarjes, arrestohet 18-vjeçari

AKTUALITET / 29 September 2026, 16:41

Rrëzimi i kërkesës së PD për mandatin e Shabanit, reagon Bardhi: GJK bëri politikë!

AKTUALITET / 29 September 2026, 16:31

Hetimet dhe operacionet e përbashkëta/ Demo takon ambasadorin italian, në fokus partneriteti strategjik për sigurinë dhe integrimin

AKTUALITET / 29 September 2026, 16:19

Dua Lipa mbështeti "Flamingot"/ Rama: Duas i pëlqen protesta, mua më pëlqen Dua

AKTUALITET / 29 September 2026, 15:51

PD kundërshtoi zgjedhjen e Shabanit si Avokat i Popullit, GJK rrëzon kërkesën

AKTUALITET / 29 September 2026, 15:39

Alarmi për inteligjencën artificiale/ OpenAI bllokoi modelin e ri, Anthropic paralajmëron për "rrezik ekzistencial"

AKTUALITET / 29 September 2026, 15:29

"Agjentët u prenë në besë", eksperti i sigurisë flet për rrezikun e publikimit të të dhënave: Rrjeti i SHISH u kompromentua

AKTUALITET / 29 September 2026, 15:12

Skandali i SHISH/ Vlora Hyseni ankimon masën "arrest shtëpie"

AKTUALITET / 29 September 2026, 14:59

Skandali në SHISH, PD kërkesë për informacion Kryeministrit dhe Presidentit për emërimin e Vlora Hysenit

AKTUALITET / 29 September 2026, 14:41

Integrimi në BE, Rama: Jemi në kontakt të vazhdueshëm me Marta Kos, është edhe Trump i mirëpritur në Union nëse do

AKTUALITET / 29 September 2026, 14:25

Rama: Në Zvërnec, investimi më i madh turistik në Evropë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.